



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERËT PUBLIKË

Nr. ____prot.

Tiranë, më 20.1.2020

Lënda: Parashtrime të Komisionerit Publik, në seancën gjyqësore të datës 20.1.2020, para trupit gjykues të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, në çështjen ankim kundër vendimit nr. 84, datë 27.11.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit z. Besnik Cani

Baza ligjore: Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neni C, pika 2, neni F, pika 2 e aneksit të Kushtetutës, neni 63 i ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”

Drejtuar: Kolegjit të Posaçëm të Apelimit

Të nderuar anëtarë të trupit gjykues,

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, me anë të vendimit nr. 84, datë 27.11.2018, ka konfirmuar në detyrë subjektin e rivlerësimit, z. Besnik Cani, aktualisht anëtar i Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

Ndaj këtij vendimi, bazuar në nenin B, pika 3, germa “c¹”, e aneksit të Kushtetutës dhe nenit 65, pika 2², e ligjit nr. 84/2016, tre vëzhgues të Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit (në vijim referuar ONM), kanë paraqitur pranë Institucionit të Komisionerëve Publikë aktin “Rekomandim për paraqitje ankimi”.

Komisioneri Publik, pas verifikimit të situatës faktike, analizës dhe vlerësimit të provave dhe akteve të dala nga hetimi administrativ i Komisionit, në konsideratë edhe të rekomandimit të ONM-së, çmon se vendimi nr. 84/2018 është i cenueshëm në tërësinë e tij, si dhe përmban shkaqe të mjaftueshme ligjore për t’u shqyrtuar nga juridiksioni rivlerësues i Kolegjit të Apelimit.

¹ Vëzhguesi ndërkombëtar ushtron këto detyra ... u jep Komisionerëve Publikë rekomandime me shkrim për të paraqitur ankim. Në rast se Komisioneri Publik nuk i zbaton rekomandimet, ai përgatit një raport me shkrim, duke dhënë arsyet e refuzimit.

² Vëzhguesi ndërkombëtar ka të drejtë t’i paraqesë rekomandim me shkrim Komisionerit Publik për të paraqitur ankim. Ky rekomandim jepet nga një komision i përbërë nga të paktën 3 përfaqësues të ONM-së.

Komisioneri Publik, duke u qëndruar të gjitha shkaqeve të parashtruara në ankim, vëren se për rastin objekt gjykimi, megjithëse kanë rezultuar rrethana dhe fakte të provuara se subjekti:

(i) *për kriterin e pasurisë*, nuk ka paraqitur prova të mjaftueshme dhe shpjegime bindëse për të kundërtën e barrës së provës, lidhur me deklaratimet e pasakta dhe të pamjaftueshme ndër vite të pasurisë, duke rezultuar dhe me mungesë të burimeve të ligjshme financiare për të përballuar njëkohësisht investimet, kursimet e deklaruara dhe shpenzimet e kryera ndër vite;

(ii) *për kriterin e aftësive profesionale*, kanë rezultuar fakte e rrethana të cilat janë në papajtueshmëri dhe cenojnë etikën dhe figurën e magistratit, mangësi të përsëritura dhe modele të papërshtatshme pune.

Komisioni, duke u bazuar në interpretime dhe zbatim të gabuar të dispozitave kushtetuese dhe kuadrit ligjor të zbatueshëm, si dhe vlerësimit të gabuar të provave, i udhëhequr nga parimi i proporcionalitetit, zbatimi i të cilit në gjykimin e Komisionerit Publik nuk është i përshtatshëm në rrethanat konkrete të provuara, ka konfirmuar në detyrë subjektin e rivlerësimit z. Besnik Cani.

Në të tilla kushte, ku subjekti rezulton me mangësi dhe mospërbushje të kërkesave të parashikuara në aneksin e Kushtetutës dhe legjislacionin e posaçëm për kriteret e procesit të rivlerësimit, Komisioneri Publik çmon se subjekti i rivlerësimit nuk arrin nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, si dhe nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, kërkesa këto të cilat së bashku duhen plotësuar sipas përcaktimit të nenit 59, pika 1, të ligjit nr. 84/2016. Nga vlerësimi tërësor i çështjes, në kuptim të nenit 4, pika 2, të ligjit nr. 84/2016, në rastin konkret gjykojmë se gjen zbatim neni 61, pikat 3, 4 dhe 5, të këtij ligji.

I. Analiza e shkaqeve të ankimit

1. Përpara se të vijojmë me trajtimin e secilës çështje objekt ankimi, me qëllim shmangien e çdo interpretimi apo pretendimi eventual të gabuar lidhur me zbatimin e nenit 59, pika 4³, të ligjit nr. 84/2016, paraprkasht Komisioneri Publik çmon të sqarojë kushtet e pranueshmërisë së këtij ankimi, i cili në këtë rast ushtrohet kundër vendimit të Komisionit në tërësinë e tij, përfshirë këtu edhe katër praktikat që Komisioni ka referuar pranë organit kompetent për inspektim.

2. Sikundër është trajtuar në mënyrë të zgjeruar në ankim, Komisioneri Publik vlerëson se kufizimi i së drejtës së ankimit, parashikuar në nenin 59, pika 4, të ligjit nr. 84/2016, nuk gjen zbatim ndaj së drejtës që i njihet Komisionerit Publik nga neni F, pika 2, e aneksit të Kushtetutës, porse ky kufizim i referohet subjektit të rivlerësimit.

I. A Për kriterin e pasurisë

3. Për vlerësimin e kriterit të pasurisë, Komisioneri Publik, ndryshe nga arsyetimi dhe përfundimet e Komisionit, vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur të provojë të kundërtën e rezultateve të hetimit pas kalimit të barrës së provës, me qëllim që, bazuar në nenin D, të aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, subjekti të vlerësohet si besueshëm për këtë kriter, e për pasojë të sillte konfirmimin në detyrë të tij.

4. Pasuritë dhe interesat private të deklaruara nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, për qëllim të procesit të rivlerësimit, janë deklaruar në deklaratën “Vetting”, dorëzuar më datë 27.1.2017 pranë ILDKPKI-së. Nga krahasimi i kësaj deklarate me deklaratat periodike të

³ Pavarësisht se subjektit të rivlerësimit i jepet vendim për konfirmimin në detyrë, Komisioni ka të drejtë të transferojë çështjen pranë organit kompetent për inspektim në rast se evidenton shkaqe që përbëjnë shkelje disiplinore, sipas legjislacionit që rregullon statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve, ose në rast se evidenton shkaqe për t'u marrë parasysh gjatë vlerësimit periodik të tij. Ndaj këtij vendimi nuk mund të bëhet ankim.

pasurisë, referuar nenit 32, pika 5, të ligjit nr. 84/2016, ndër të tjera, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar këto pasuri:

5. Pasuria 1. Në D-Vett., subjekti deklaron: “Apartament” me sipërfaqe 104.77 m², i ndodhur në adresën rruga “****.***”, Tiranë, blerë për vlerën 8.308.261 lekë, sipas kontratës noteriale të shitjes së pasurisë me nr. *** rep., nr. *** kol., datë ***.7.2008, me pjesë takuese 100% në pronësi të subjektit.

Si **burim** i krijimit të kësaj pasurie, deklarohen: **(i)** kursime nga të ardhurat personale dhe të bashkëshortes; **(ii)** detyrimet familjare etj.; **(iii)** kredi bankare e marrë nga *** Bank, në shumën 40.000 euro; **(iv)** kursime ndër vite dhe **(v)** hua pa interes në shumën 6.000 euro nga shtetasi ***.***, (i afërm/baxhanaku i subjektit), me vendbanim në Greqi.

5.1 Në DV për vitin 2005 (dorëzuar në mars 2006), ku pasuria e mësipërme deklarohet për herë të parë, subjekti ka deklaruar: “Apartament” banimi me sipërfaqe 117 m²..., bazuar në kontratën noteriale të sipërmarrjes të datës ***.9.2005, për vlerën 69.000 euro, pjesa takuese 50%.

5.2 Në DV-2005, në rubrikën “detyrime financiare ndaj personave fizikë dhe juridikë”, subjekti ka deklaruar: “detyrim për blerje ap... ndaj shoqërisë “****”, në shumën 48.000 euro. Paga 21.000 euro është bërë me: **(i)** 3.500 USD të mbartura nga viti 2004; **(ii)** 6.000 euro hua e marrë nga baxhanaku në Greqi; **(iii)** hapje mbyllje depozite në shumën 50.000 lekë; **(iv)** 500.000 lekë, marrë tek të afërmit pa afat dhe pa interes dhe **(v)** kursimet e vitit 2005 në shumën 1.050.000 lekë”.

5.3 Nga krahasimi i D-Vett. me atë DV-2005, referuar nenit 32, pika 5, të ligjit nr. 84/2016, mes të tjerash, rezulton se deklarimi i burimit të krijimit të kësaj pasurie është i ndryshëm. Në D-Vett., subjekti nuk ka deklaruar saktësisht burimin e krijimit të pasurisë, pasi nuk deklarohet huaja në vlerën 500.000 lekë, e deklaruar në DV-2005.

5.4 Lidhur me likuidimin e çmimit të kësaj pasurie, nga aktet e administruara në dosje rezulton se, sipas kontratës së sipërmarrjes së datës ***.9.2005, subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e porositesit dhe shoqëria “****” sh.p.k., në cilësinë e sipërmarrësit, kanë rënë dakord për ndërtimin e pasurisë “Apartament”, me sip.116.42 m², për vlerën 69.000 euro. Sipas të drejtave dhe detyrimeve të palëve kontraktuese, pagesa e plotë e çmimit të pasurisë do të kryhej në katër këste, sipas të cilave: **(i)** kësti i parë, në shumën 15.000 euro, është paguar në datën e nënshkrimit të kontratës, në *** shtator 2005; **(ii)** kësti i dytë, në shumën 6.000 euro, të shlyhet në *** tetor 2005; **(iii)** kësti i tretë, në shumën 46.000 euro, të shlyhet në *** janar 2006 dhe **(iv)** kësti i katërt dhe i fundit, në shumën 2.000 euro, të shlyhet në momentin e dorëzimit të çelësave të apartamentit nga pala sipërmarrëse.

5.5 Për sa më sipër, rezulton se subjekti deri në fund të vitit 2005⁴ ka shlyer pjesërisht detyrimin në shumën 21.000 euro dhe në vitin 2006 ka shlyer pjesën e mbetur prej 48.000 euro. Për këtë arsye, analiza ekonomike-financiare në vijim, e kryer me qëllim verifikimin e vërtetësisë së deklarimit të subjektit mbi ekzistencën e burimeve të ligjshme të të ardhurave dhe mjaftueshmërisë së tyre për mbulimin e shpenzimeve të kryera dhe krijimin e këtij aseti, do të shtrihet për periudhën 2005 - 2006.

⁴ Sipas nenit 3 të kontratës së sipërmarrjes, subjekti duhet të arkëtojë shumën 15.000 euro pranë shoqërisë “****” sh.p.k. Gjithashtu, në përgjigjet e pyetësorit nr. ***, datë ***.3.2018, subjekti deklaron: “...me nënshkrimin e kontratës së sipërmarrjes kam paguar, pranë arkës së shoqërisë, shumën prej 15.000 euro”.

6. Për vitin 2005, subjekti ka shlyer në muajin shtator shumën 15.000 euro dhe në tetor shumën 6.000 euro⁵. Për krijimin e shumës 15.000 euro kanë shërbyer si të ardhura: **(i)** 3.500 USD kursime të mbartura nga viti 2004; **(ii)** hapje-mbyllje depozite në shumën 50.000 lekë; **(iii)** 500.000 lekë të marra hua tek të afërmit, pa afat dhe pa interes dhe **(iv)** kursimet e vitit 2005, në shumën 1.050.000 lekë.

6.1 Në analizë të secilit zë të mësipërm, që kanë shërbyer për krijimin e shumës 15.000 euro, rezulton se:

(i) Për kursimin në shumën 3.500 USD⁶, deklaruar në DV-2005, si të mbartura nga viti 2004, rezulton se subjekti nuk e ka deklaruar këtë shumë si gjendje në bankë në deklaratën periodike për vitin 2004.

Sipas lëvizjeve të llogarisë, të vëna në dispozicion nga *** Bank, kjo shumë është depozituar nga subjekti në datën ***.11.2004 dhe është tërhequr në datën ***.2.2005.

(ii) Për depozitën në vlerën 50.000 lekë, referuar shkresës së datës ***.12.2017, Banka ***.***.*** sh.a., konfirmon derdhjen *cash* në llogarinë e subjektit të kësaj shume, më datë ***.9.2005. Pra, ky transaksion është kryer pas pagesës së kështit të parë të kontratës së sipërmarrjes (*** shtator 2005). Në këto kushte, kjo depozitë nuk është marrë në konsideratë në analizë financiare, si pjesë e burimit për pagesën e kështit të parë.

(iii) Për huan në shumën 500.000 lekë, deklaruar nga subjekti në DV- 2005, si hua e marrë tek të afërmit, pa afat dhe pa interes. Ndërkohë në rubrikën **“të dhëna që nuk publikohen”** të deklaratës vjetore, subjekti ka deklaruar *“detyrime ndaj motrave e vëllezërve të mi dhe të bashkëshortes”*.

Duke qenë se subjekti nuk ka deklaruar saktësisht dhe qartësisht, Komisioni e ka pyetur subjektin lidhur me rrethin e personave huadhënës dhe, në përgjigjet e pyetësorit nr. ***, subjekti ka deklaruar se, *“...këtë detyrim të krijuar e kam ndaj baxhanakut tim ***.***”*.

Për të provuar këtë marrëdhënie huaje, subjekti ka paraqitur deklaratën noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë ***.01.2017, të shtetasit ***.***. Ky i fundit, në këtë deklaratë noteriale deklaronte se, *“...në periudhën nga vitit 2005 deri në vitin 2009 i kam dhënë disa herë hua subjektit për nevoja familjare shuma parash baxhanakut tim z. Besnik Cani... në total prej 1.000.000 lekësh⁷”*.

6.2 Komisioneri Publik vlerëson se marrëdhënia e huas sërish mbetet e pasqaruar, pasi nga aktet e administruara nuk rezulton e provuar: data, mënyra e marrjes dhe e shlyerjes së huas/ve. Nga përmbajtja në deklaratimet periodike konstatohen deklarata kontradiktore me përgjigjet e pyetësorëve të administruara në dosje gjatë hetimit të Komisionit lidhur me këto huamarrje.

6.2.1 Në referencë të jurisprudencës së Kolegjit në lidhje me situata të ngjashme në procesin e rivlerësimit, rezulton se në këtë rast Komisioni nuk ka zbatuar drejt kriteret e nenit 49, pika 4, të

⁵ Kjo shumë deklarohet nga subjekti si hua e marrë nga i afërmi i tij, z. ***.***. Bazuar në pikën 4, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016, Komisioni e ka konsideruar huadhënësin, si person tjetër të lidhur dhe ka hetuar lidhur me të ardhurat e realizuara prej tij. Nga nxjerrja e llogarisë bashkëlidhur shkresës nr. ***, datë ***.12.2017, të *** Bank konstatohet një transfertë në mbërritje, në shumën 5.990 euro, datë ***.10.2005, dhe tërheqja e po kësaj shume, në datën ***.10.2005. Për të provuar aftësinë e huadhënësit, subjekti ka paraqitur në Komision si provë shkresore dokumentacion nga organet tatimore greke, që vërteton të ardhurat e ligjshme të huadhënësit, në periudhën 2004-2006, shoqëruar me vulë apostile. Gjithashtu, lidhur me këtë transaksion, subjekti ka vënë në dispozicion dhe nxjerrje të llogarisë bankare të shtetasit ***.***, nga *** Bank Greece, ku konfirmohet transferta e kryer në datën ***.10.2005, në shumën 6.011.74 euro dhe në të njëjtën kohë kreditohet llogaria e subjektit në datën ***.10.2005. Kjo shumë e marrë hua korrespondon me pagesën e kështit të dytë sipas modaliteteve të pagesës në kontratën e sipërmarrjes, sipas së cilës parashikohet pagesa e shumës prej 6.000 euro, brenda datës ***.10.2005.

⁶ Referuar korrespondencës zyrtare me *** Bank, subjekti ka tërhequr nga llogaria e tij 3.500 USD, në datën ***.2.2005.

⁷ Sipas deklaratës noteriale të z. ***.***, me nr. *** rep., nr. *** kol., datë ***.3.2018, deklarohet se në periudhën gusht 2017-dhjetor 2017, subjekti i rivlerësimit e ka shlyer me këste shumën prej 1.000.000 lekësh.

ligjit nr. 84/2016, teksta u ka dhënë fuqi të plotë provuese deklaratave noteriale të dorëzuara gjatë hetimit administrativ, jo në harmoni dhe në vlerësim me provat e tjera. Deklaratat noteriale datojnë pas dorëzimit të deklaratës “Vetting”, ato janë administruar gjatë hetimit administrativ dhe, si të tilla, ashtu sikurse edhe pretendimet e paraqitura nga subjekti, mbeten në nivel deklarativ. Ato nuk mund të konfirmojnë të vetme dhe jo në harmoni me prova të tjera, provueshmërinë që faktet e deklaruara në to, kanë ndodhur realisht⁸.

6.2.2 Nga analiza financiare e kryer nga Komisioneri Publik, edhe nëse e konsiderojmë shumën prej 500.000 lekë, si burim të ligjshëm, referuar nenit D, pika 3, të aneksit të Kushtetutës dhe nenit 32, pika 4, të ligjit nr. 84/2016, sërish rezulton se subjekti i rivlerësimit nuk ka të ardhura të mjaftueshme nga burime të ligjshme, për të kryer pagesën e kështit përkatës të kontratës së sipërmarrjes në vitin 2005.

(iv) *Për kursimet në shumën 1.050.000 lekë*, nga analiza financiare, rezulton se subjekti nuk ka pasur mundësi që deri në *** shtator 2005, moment në të cilin është paguar kësti i parë i kontratës së sipërmarrjes, të kursejë këtë shumë të deklaruar, duke rezultuar me një balancë negative prej **621.085 lekë**.

6.3 Lidhur me këtë situatë faktike, pamjaftueshmërinë e të ardhurave të ligjshme në blerjen e apartamentit, Komisioni ia ka kaluar barrën e provës subjektit të rivlerësimit dhe në parashtrimet e tij të datës 21.7.2018, subjekti ka deklaruar se: “... *diferenca është e justifikueshme me diferencat e standardit të jetesës mes qytetit dhe fshatit.*” Ndërsa, në parashtrimet përfundimtare, datë 20.11.2018, subjekti ka deklaruar se: “... *diferencat negative të viteve 2005-2006, vijnë si pasojë e mosdeklarimit nga ana ime e gjendjeve cash në banesë*”.

6.4 Në vlerësimin e Komisionerit Publik, ky pretendim i subjektit se diferencat negative të viteve 2005-2006, vijnë si pasojë e mosdeklarimit nga ana e tij të gjendjeve *cash* në banesë, është një pretendim i pabazuar. Në këtë drejtim, bazuar në nenin 32, pika 5, të ligjit nr. 84/2016, lidhur me ligjin nr. 9049/2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive...”, të ndryshuar, subjekti ka pasur detyrimin të deklarojë saktësisht gjendjen *cash* në fund të periudhës së deklarimit. Gjithashtu, theksojmë se shpenzimet e llogaritura nga Komisioni për shpenzimet jetese, u referohen standardit të pranuar të ILDKPKI-së, që bazohen në burimet e INSTAT-it.

7. Për vitin 2006, në deklarimin periodik vjetor, subjekti ka deklaruar se ka likuiduar detyrimin ndaj firmës “****” sh.p.k., në vlerën 48.000 euro. Në po këtë vit, subjekti ka deklaruar kredi për shtëpi banimi nga *** Bank, në shumën 40.000 euro, datë ***.1.2006, dhe hua nga të afërmit pa interes, në shumën 350.000 lekë.

7.1 Lidhur me huan, rezulton se subjekti në të njëjtën deklaratë vjetore, në faqen nr. 8, ka deklaruar si huadhënës shtetasin (baxhanakun), z. ***.***, por edhe në këtë rast pa sqaruar dhe provuar datën dhe mënyrën e marrjes së kësaj huaje. Ndërkohë, në përgjigjet e pyetësorit nr. ***, të Komisionit, i pyetur për huadhënësin dhe mënyrën e marrjes së huas, subjekti deklaroi të tjera rrethana, duke parashtruar se huan e ka marrë nga z. ***.***. Kontradiktat e subjektit në deklarimin e huadhënësit dhe justifikimin e huave me deklaratën noteriale të depozituar si provë pranë Komisionit, ngrenë dyshime për aq kohë sa subjekti nuk arrin të provojë me dokumentacion mbështetës marrjen dhe shlyerjen e këtyre huave.

7.2 Referuar modaliteteve të pagesës sipas kontratës së sipërmarrjes të vitit 2005, subjekti ka rënë dakord të paguajë kështin prej 46.000 euro në datën ***.1.2006, nga të cilat 40.000 euro kredi

⁸ Për më tepër referohuni në vendimin e KPA-së (JR) nr. 10, datë 19.11.2018.

nga *** Bank, konfirmuar nga kjo e fundit dhe e disbursuar në llogarinë bankare të subjektit më datë ***.1.2006.

7.3 Nga analiza ekonomiko-financiare, rezulton se diferenca prej 6.000 euro, mbetur për t'u paguar deri në datë *** janar 2006, nuk mbulohet me të ardhura nga burime të ligjshme të subjektit, të cilat deri në këtë moment janë në total në shumën rreth 58.000 lekë, referuar lëvizjeve në llogaritë bankare të subjektit dhe bashkëshortes së tij. Në këtë analizë, edhe nëse e konsiderojmë si të ardhur të ligjshme huan e deklaruar, rezulton se subjekti nuk ka pasur mjaftueshëm të ardhura të ligjshme financiare për të mbuluar shpenzimet, kursimet dhe pagesën e kryer në favor të shoqërisë sipërmarrëse, me një diferencë negative prej 127.000 lekë.

7.4 Ndërkohë, në analizën financiare për vitet 2005-2006, në zërin "shpenzime" nuk janë përfshirë shpenzime mobilimi, duke qenë se subjekti **nuk ka deklaruar asnjëherë shpenzime mobilimi**, as në vitet 2005-2006, kur ka blerë këtë apartament dhe as në vitet pasardhëse, kur e ka poseduar këtë pasuri, e më pas i ka kaluar në pronësinë e tij. Nëse në analizën financiare për vitet 2005-2006 do të përfshiheshin edhe shpenzime për mobilimin e këtij apartamenti, diferenca negative e gjendjes financiare të subjektit të rivlerësimit do të rritej.

8. Komisioneri Publik, duke përfunduar për sa më sipër për pasurinë 1, vlerëson se në analizë të situatës faktike dhe të provave të administruara, mbetet i paprovuar plotësisht burimi i ligjshëm dhe i të ardhurave të ligjshme që kanë shërbyer për krijimin e kësaj pasurie në pronësi të subjektit të rivlerësimit, referuar nenit D, të aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016. Në këto kushte, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarim të pasaktë dhe të pamjaftueshëm për kriterin e kontrollit të pasurisë, referuar nenit 33, pika 5, germa "b", të ligjit nr. 84/2016, lidhur me nenin 61, pika 3, të këtij ligji.

8.1 Për sa më sipër, e gjejmë të pabazuar, në prova dhe në ligj, përfundimin e arritur nga Komisioni në arsyetimin e vendimit, se *"... këto pasaktësi dhe këto mangësi të burimeve financiare, për një total të akumuluar në pesë vite (dhe të shpërndara në harkun kohor 11-vjeçar), në shumën prej 819.812 lekësh⁹, nuk janë të mjaftueshme që të pasjellin aplikimin e pikës 3 të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, pasi vlerësimi sigurisht që duhet të kryhet nëpërmjet një analize kritike, por ai duhet të jetë gjithëpërfshirës dhe në përputhje me parimin e proporcionalitetit."*

8.2 Vlerësojmë se në rastin konkret, referenca e Komisionit të parimi i "proporcionalitetit", për të justifikuar moszbatimin e nenit 61, pika 3, të ligjit nr. 84/2016, sikundër dhe për mangësitë dhe problematikat e vërejtura për kriterin e aftësive profesionale¹⁰, është mbështetur në një interpretim dhe zbatim të gabuar të kuadrit kushtetues e ligjor. Parimi i proporcionalitetit, si një nga parimet "klasike" që ka gjetur vlerësim të vazhdueshëm në jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese dhe të GJEDNJ-së, është trajtuar gjerësisht lidhur me të drejtat e njeriut, mbrojtja e të cilave përbëjnë dhe bazën në një shoqëri demokratike. Lidhur me këtë parim, Gjykata Kushtetuese në vendimin e saj nr. 40/2014, ndër të tjera, ka theksuar se: [*... Proporcionalitetin e një kufizimi ajo e vlerëson rast pas rasti, duke pasur parasysh disa aspekte, si balancën mes të drejtës/garancisë së kufizuar dhe interesit publik, mjetin e përdorur në raport me gjendjen që e ka diktuar atë, të drejtën/garancinë e cenuar dhe synimin që kërkon të arrijë legjislatori.*]

8.3 Në këtë kontekst, nuk duhet të përjashtojmë natyrën e procesit të rivlerësimit, qëllimi parësor i të cilit është kthimi i besimit të publikut. Juridiksioni kushtetues i organeve që janë ngarkuar për kryerjen e këtij procesi, nuk mund të vihet në diskutim, pasi është vetë Kushtetuta

⁹ Me bilancin më negativ ndër këto 5 vite, që arrin në 258.978 lekë, në vitin 2005.

¹⁰ Marrëdhënia civile me shoqërinë "****" sh.p.k, dhe përfitimit të statusit të familjes së pastrehë.

dhe ligji të cilat kanë parashikuar parimet dhe garancitë e nevojshme ndaj subjekteve që i nënshtrohen procedurës së rivlerësimit¹¹, ashtu dhe kufizimet përkatëse.

8.4 Si rrjedhojë, masat e marra nga organet e rivlerësimit gjatë veprimtarisë së këtij juridiksioni të posaçëm, e për më tepër në rastet kur konstatohen jo vetëm një, por disa problematika mbi kriteret e rivlerësimit, parimi i proporcionalitetit nuk mund të shërbejë si *'strehë'* për anashkalimin e vetë qëllimit të procesit të rivlerësimit dhe zbatimit korrekt të ligjit.

9. Pasuria 2. Në D-Vett., deklarohej: “Truall” me sipërfaqe 633.8 m² dhe një banesë private me sip. 112 m², me vendndodhje ***, Tiranë. Pasuria është fituar me legalizim nga ALUIZNI¹² në vitin 2009, me vlerë 721.400 lekë (parcelë ndërtimore), 30.732 lekë (taksë ndikimi në infrastrukturë), 100 % në pronësi të subjektit.

Si burim i krijimit të kësaj pasurie deklarohet: (i) kursime nga të ardhurat personale dhe të bashkëshortes, (ii) detyrime familjare etj.

9.1 Në DV- 2003, deklarohej: “Banesë private” me sipërfaqe 100 m², komuna ***, e ndërtuar që nga viti 1995, me kosto ndërtimi 700.000 lekë. Si burim krijimi deklarohen: (i) kursime familjare dhe (ii) kursimet nga emigracioni 1993-1994.

9.2 Nga hetimi administrativ, Komisionit i ka rezultuar: **(i)** mospërputhje midis sipërfaqes e tokës dhe të ndërtesës të vetëdeklaruar për legalizim nga subjekti dhe të sipërfaqeve faktike të legalizuara; **(ii)** paqartësi për kohën dhe periudhën e ndërtimit të shtëpisë; **(iii)** mungesë dokumentacioni ligjor lidhur me burimin e krijimit të pasurisë dhe mënyrën e ndërtimit, rrethana faktike këto për të cilat Komisioni i ka kaluar subjektit barrën e provës. Pasi ka administruar shpjegimet dhe provat e subjektit për të kundërtën, Komisioni, ndër të tjera, ka konkluduar se: *“...subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarime të pasakta në lidhje me sipërfaqet e banesës dhe të terrenit në ***, si dhe ka munguar të deklarojë posedimin e terrenit në vitet para legalizimit; ... gjithësesi shpjegimet dhe dokumentacionet e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit konsiderohen deri diku bindës për sa u përket pasaktësive ... edhe pse mund të konsiderohet si një fakt historik real informaliteti në Shqipëri asokohe – subjekti, përtej shpjegimeve, nuk ka dhënë asnjë provë konkrete lidhur me shpenzimet e kryera për ndërtimin e banesës në *** dhe të burimit të tyre”.*

10. Komisioneri Publik vlerëson të ripërsërisë edhe në këtë rast, se në referencë të jurisprudencës së Kolegjit, në lidhje me situata të ngjashme në procesin e rivlerësimit, Komisioni nuk ka zbatuar drejt kriteret e nenit 49/4, të ligjit nr. 84/2016, teksa u ka dhënë fuqi të plotë provuese deklaratave noteriale të dorëzuara nga subjekti, pa arsyetuar bazueshmërinë e këtij qëndrimi, në analizë të objektit dhe provueshmërisë së deklaratave noteriale në harmoni me provat e tjera të administruara.

10.1 Risjellim në vëmendje se deklaratat noteriale datojnë pas dorëzimit të D-Vett., janë administruar gjatë hetimit administrativ dhe, si të tilla, ashtu sikurse edhe pretendimet e paraqitura nga subjekti, mbeten në nivelin deklarativ. Ato nuk mund të konfirmojnë të vetme, jo në harmoni me provat e tjera dhe në mënyrë të besueshme, provueshmërinë që faktet e deklaruara në to kanë ndodhur realisht¹³.

10.2 Gjithashtu, konstatojmë se Komisioni, edhe në këtë rast, mbështetur në një interpretim dhe zbatim të gabuar të legjislacionit, lidhur me parimin e proporcionalitetit në procesin e rivlerësimit, ndër të tjera, ka konkluduar se: *“...vlerësimi i veprimeve juridike dhe deklarimeve që subjekti i*

¹¹ Për më tepër, referohuni edhe në opinionin CDL-AD (2016) 036, të Komisionit të Venecias.

¹² Kontratë e kalimit të parcelës ndërtimore nr. *** rep., nr.*** kol. datë ***.6.2009.

¹³ Për më tepër, në këtë drejtim, referohuni në vendimin e KPA-së (JR), nr. 10/2018.

rivlerësimit ka dhënë në lidhje me këtë pasuri, edhe pse nuk rezultoi i provuar çdo pretendim i tij, në vetvete dhe të vetme këto pasaktësi apo veprime ose mosveprime, nuk mund të pasjellin aplikimin e pikës 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, pasi kjo do të binte ndesh me parimin e proporcionalitetit”.

10.3 Komisioneri Publik, ndryshe nga ky përfundim i arritur nga Komisioni, konstaton se subjekti nuk arrin të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm e krijimit të kësaj pasurie, sikurse dhe vërtetësia e deklarimeve të subjektit mbi rrethanat e krijimit dhe posedimit të saj. Në këto kushte, vlerësojmë se, në rastin konkret, gjen zbatim neni 61, pika 3 dhe 5, të ligjit nr. 84/2016.

11. Pasuria 3. Në D-Vett., subjekti ka deklaruar: Autoveturë Mercedes-Benz, viti prodhimit 2006, blerë me kontratë shitblerje nr. *** rep., nr. *** kol., datë ***.1.2012, për vlerën 1.300.000 lekë, në bashkëpronësi me bashkëshorten. Si burim i krijimit të pasurisë deklarohen të ardhurat familjare.

11.1 Në DV-2012 deklarohen të njëjta rrethana si më sipër, por pa u deklaruar burimi i krijimit.

12. Pasuria 4, në D-Vett., subjekti ka deklaruar: “Garazh” me sip 18.7 m², në pallatin e shoqërisë “****” sh.p.k, rruga “****.****”, Tiranë, blerë me kontratën nr. *** rep., nr. *** kol., datë ***.4.2012, për vlerën 7.000 euro. Si burim i krijimit të pasurisë deklarohen të ardhurat familjare.

12.1 Në DV-2012 deklarohen të njëjta rrethana si më sipër, por pa u deklaruar burimi i krijimit.

13. Komisioneri Publik, nga analiza financiare mbi të ardhurat dhe shpenzimet e subjektit të rivlerësimit për periudhën 2010- 2015, përveç sa trajtuar më sipër, lidhur me pasurinë 1, konstaton se subjekti nuk mbulon me të ardhura nga burime të ligjshme shpenzimet dhe investimet gjatë këtyre viteve, për një diferencë totale negative prej 2.152.963 lekësh, përfshirë këtu dhe vitin 2012, që përkon me vitin e krijimit të pasurisë 3 dhe 4¹⁴.

14. Duke përfunduar për kriterin e pasurisë, Komisioneri Publik, bazuar në analizën e akteve dhe prova të administruara, ndryshe nga përfundimet e Komisionit, vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk arrin nivel të besueshëm për konfirmimin e tij në detyrë, pasi gjendet në kushtet e deklaramit të pasaktë dhe të pamjaftueshëm të pasurisë, duke rezultuar me mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasurinë, në kuptim të nenit D, të aneksit të Kushtetutës, nenit 33, pika 5, germa “b” dhe nenit 61, pika 3, të ligjit nr. 84/2016.

I. B Për vlerësimin e kriterit të aftësive profesionale

15. Nga hetimi administrativ i Komisionit janë konstatuar mangësi në etikën dhe profesionalizmin e subjektit të rivlerësimit, të tilla që, për nga karakteri dhe përsëritja, bazuar në nenin E, të aneksit të Kushtetutës dhe nenin 52, të ligjit nr. 84/2016, e kanë detyruar Komisionin t’i kalojë subjektit barrën e provës për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

16. Me gjithë problematikat e konstatuara, Komisioni, në përfundim, ka vlerësuar se subjekti arrin një nivel minimal kualifikimi dhe duhet të konfirmohet në detyrë. Në të njëjtën kohë, Komisioni ka vendosur që disa nga çështjet ku evidentohen mangësitë të lidhura me etikën dhe profesionalizmin e subjektit, t’ia transferojë organit kompetent për inspektimin e shkeljeve të mundshme disiplinore. Çështjet e transferuara janë katër, si vijon:

16.1 Marrëdhënies juridiko-civile, ndërmjet subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur, me shoqërinë “****” sh.p.k.;

16.2 Procedimi penal nr. ***, viti 2006, i Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë;

¹⁴ Diferenca negative për vitin 2012 është në shumën 517.209 lekë.

16.3 Procedimi penal nr. ***, viti 2012, i Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Fier, së bashku me praktikën për përfitimin e statusit të pastrehë nga subjekti, në bazë të Vendimit të Këshillit Bashkiak Fier, nr. 14, datë 28.3.2013;

16.4 Procedimi penal nr. ***, viti 2015, i Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Elbasan.

17. Komisioneri Publik, në analizë të gjetjeve të vetë Komisionit për çështjet e mësipërme, vlerëson se subjekti ndodhet në kushtet e mosarritjes së nivelit minimal kualifikues, referuar etikës dhe aftësive profesionale të tij. Si rrjedhojë, në konsideratë të qëllimit të nenit 179/b, pika 1, të Kushtetutës, kërkesave të nenit E, të aneksit të Kushtetutës, nenit 59, 61, pikat 4 dhe 5 të ligjit nr. 84/2016, dhe për aq sa gjen zbatim ligji nr. 96/2016, mangësitë e konstatuara sjellin një përfundim të ndryshëm në lidhje me konfirmimin në detyrë të subjektit.

Lidhur me etikën

18. Marrëdhënia juridiko - civile ndërmjet subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur, me shoqërinë “*” SHPK**

18.1 Për këtë situatë faktike, Komisioni, pasi ka administruar përgjigjet dhe provat e subjektit të rivlerësimit për të provuar të kundërtën e barrës së provës, ka arritur në përfundimin se: *“...termi ‘kontratë qiraje’ është i papërshtatshëm dhe jo koherent me përmbajtjen dhe me efektet që prodhon kontrata në fjalë... Ky konkluzion arrihet jo vetëm për faktin...se kontrata është hartuar nga departamenti juridik i shoqërisë ‘***’ sh.p.k., ..., por kryesisht për rrethanën e provuar nëpërmjet një sërë kontratash qiraje të lidhura nga shoqëri të ndryshme me të tretë, ku ‘pagesa e qirasë bëhet me lekë për litër’. Sa më lart e përjashton hipotezën se subjekti i rivlerësimit mund të ketë lidhur një kontratë të emëruar ‘qiraje’, me qëllim që të fshehte efektet reale të saj - edhe pse të ndryshme nga ato që prodhon një kontratë e mirëfilltë qiraje”.*

18.2 **Komisioneri Publik** vlerëson se qëndrimi i Komisionit është kontradiktor dhe jo bindës, nisur nga krahasimi i marrëdhënies kontraktuale me subjektin nga njëra anë dhe ato të shoqërisë “***” SHPK, me subjekte të tjera, referuar kontratave të ngjashme të administruara në cilësinë e provës. Konstatohet se elementet kontraktuale në secilën prej tyre (kontratave) paraqiten të ndryshme në efektet ligjore që passjellin. Në analizë të përmbajtjes së këtyre kontratave, konstatojmë se ato janë kontrata tipike qiraje në kuptim të nenit 801 të Kodit Civil¹⁵ dhe vetëm kontrata e datës ***.3.2017 është një kontratë e ngjashme me kontratën që shoqëria “***” SHPK ka lidhur me subjektin.

18.3 Megjithatë, edhe në këtë rast të ngjashëm, kontrata e ofruar për referencë ka ndryshime të qenësishme lidhur me elementë të saj si: (i) investimin, i cili sipas kontratës konkrete me subjektin, i mbetet këtij të fundit, ndërsa në kontratën e ngjashme, investimi i mbetet shoqërisë “***” SHPK; (ii) në fund të kohëzgjatjes së kontratës me subjektin e rivlerësimit, subjekti do të bëhet pronar mbi objektet e ndërtuara në tokën e tij, ndërkohë që ky fakt nuk parashikohet në kontratën e ofruar për referencë. Nisur nga këto elemente, që janë pjesë vetëm e kontratës që subjekti ka lidhur me shoqërinë “***” SHPK, rezulton se kjo marrëdhënie juridiko-civile është me natyrë preferenciale. Në këtë arsyetim ligjor dhe faktik, nuk mund të mos merret në konsideratë edhe shprehja e vullnetit të shoqërisë qiramarrëse, kur vetëm dy muaj pas fillimit të pagesës së qirasë¹⁶ (në datë ***.4.2017), ka hequr dorë nga e drejta e përdorimit me afat 25-vjeçar dhe marrjes së fitimit financiar të lavazhit

¹⁵ Qiraja është kontrata me të cilën njëra palë (qiradhënësi) detyrohet t’i japë palës tjetër (qiramarrësit) një send të caktuar, në gëzim të përkohshëm kundrejt një shpërblimi të caktuar.

¹⁶ Sipas kushtit kontraktor, *“Pagesa e qirasë do të përllongaritet duke nisur nga data që qiramarrësi do të fillojë aktivitetin e shitjes së karburanteve”*, fakt ky i ndodhur në shkurt 2017.

dhe lokalit bar-kafe (të ndërtuara me investimin e shoqërisë), pa asnjë kompensim financiar nga ana e subjektit.

18.4 Komisioneri Publik, referuar nenit 681¹⁷ dhe 801, të Kodit Civil, vlerëson që kontrata e subjektit të rivlerësimit edhe pse *de jure* është emërtuar si “kontratë qiraje”, *de facto* ajo konsiston në një marrëdhënie tregtare, ku subjekti është pjesëmarrës në fitimin e shoqërisë për atë pjesë të kapitalit sipas përcaktimeve në kontratë. Elementet kontraktuale që të çojnë në këtë përfundim janë si vijon:

(i) Pagesa e qirasë nuk është një tarifë fikse, por përbëhet nga një shumë monetare që varion në bazë të ecurisë së biznesit dhe subjekti dukshëm merr përsipër riskun që qiraja të reduktohet edhe në vlerën zero, në rast falimentimi. Kjo e dallon qartë nga elementet e qirasë që parashikon Kodi Civil, në të cilin neni 801 kërkon “një shpërblim të caktuar”.

(ii) Subjekti kontribuon në natyrë duke i ofruar shoqërisë “****” SHPK një parcelë toke në këmbim të marrjes së një përqindje të qarkullimit monetar, që realizohet nga shitja e karburantit. (iii) Me parashikimin e nenit 3.2 në kontratë, ku subjekti merr 5 lekë/bruto për çdo litër karburant të shitur në atë muaj në stacionin e karburantit, nënkupton që palët ndajnë fitimin e aktivitetit tregtar. Për më tepër, shoqëria “****” SHPK do të paguajë të gjitha taksat që duhet t’i paguajë subjekti i rivlerësimit nga “qiraja mujore”.

(iv) Përcaktimi në kontratë se 50% e fitimit neto mbi shumën mujore do të shërbejë për kompensimin e investitorit, shoqërisë “****” SHPK, për ndërtimin e stacionit të tregtimit të karburantit, lokalit dhe lavazhit, është një tregues më tepër që subjekti i rivlerësimit po investon dhe kontribuon në krijimin e objekteve të veprimtarisë tregtare.

18.5 Nga analizimi i të ardhurave nga vlera e qirasë dhe nga aktiviteti ekonomik (lavazh/bar – kafe) administruar nga djali i subjektit, z. ***.***, rezulton se të ardhurat e përfituar nga marrëdhënia me shoqërinë “****” SHPK., për vitin 2017, janë në shumën prej 4.384.942,20 lekë, duke zënë rreth 70% të totalit, të të ardhurave të familjes së subjektit të rivlerësimit.

18.6 Sa më sipër, përfaqëson aspektin financiar të kësaj marrëdhënie juridiko-civile, por elementi që është më i rëndësishëm e që duhet të gjejë trajtim në procesin e rivlerësimit të subjektit është vlerësimi në raport me përgjegjësitë etike, si përgjegjësi ligjore dhe të analizimit, nëse jemi përballë cenimit të tyre, referuar nenit 149/ç¹⁸, të Kushtetutës, ligjit nr. 96/2016¹⁹ dhe urdhrin nr. 141/2014²⁰, të Prokurorit të Përgjithshëm, “Për miratimin e rregullave mbi etikën dhe sjelljen e prokurorëve”, në fuqi para se ligji nr. 96/2016 të fillonte efektet e tij.

¹⁷ Kur interpretohet një kontratë, duhet të sqarohet se cili ka qenë qëllimi i vërtetë dhe i përbashkët i palëve, pa u ndalur në kuptimin letrar të fjalëve, si dhe duke vlerësuar sjelljen e tyre në tërësi, para e pas përfundimit të kontratës.

¹⁸ “Qenia Prokuror i Përgjithshëm, prokuror ose anëtar i Këshillit të Lartë të Prokurorisë nuk pajtohet me asnjë veprimtari tjetër shtetërore ose politike, si dhe me veprimtari profesionale që ushtrohet kundrejt pagesës, me përjashtim të aktivitetit mësimdhënës, akademik ose shkencor.”

¹⁹ Ligji nr. 96/2016, në nenin 7 të tij, ka renditur si kritere ndaluese gjatë ushtrimit të funksionit të magjistratit, të tillë, si: “...të administrojë, të drejtojë ose të ushtrojë ndikim në shoqëritë tregtare ose fitimprurëse, personalisht ose nëpërmjet përfaqësimit” dhe “të zotërojë në mënyrë pasive aksione ose pjesë të kapitalit të një shoqërie tregtare, në të cilën veprimtaria e magjistratit është e ndaluar, për shkak se mund të ndikojë në pavarësinë e magjistratit, krijon konflikt interesi ose krijon përshtypjen që magjistrati është i njëanshëm ose i ndikuar ...”. Gjithashtu, neni 4, i këtij ligji, përcakton se: “Magjistrati merr të gjitha masat e arsyeshme për të ruajtur dinjitetin e funksionit, duke përfshirë veprimtaritë e kryera edhe kur magjistrati nuk është duke ushtruar funksionet zyrtare. 2. Magjistrati merr të gjitha masat për të mbrojtur dhe forcuar: a) dinjitetin dhe standardet e funksionit të tij; b) reputacionin e organeve të drejtësisë dhe besimin e publikut në sistemin gjyqësor dhe atë të prokurorisë; c) statusin e funksionit të magjistratit...”.

²⁰ Sipas nenit 4, paragrafi 1, shkronjat “ç” dhe “d”, të “Rregullave mbi etikën”, parashikohet se prokurorët duhet: “ç) Të mos zhvillojnë veprimtari ekonomike, përfshirë çdo lloj pune apo biznesi për të përfituar interesa materiale ose jomateriale, që mund të ndikojnë në pavarësinë e tyre, ose që mund të krijojnë përshtypjen e përdorimit të detyrës për interesat e tyre ose personave të tjerë... dhe “d) Të mos ndikohen nga interesat e grupeve të caktuara”. Për më tepër, neni 11, i “Rregullave...” ndalon përfitimet

18.7 Në analizë të këtij kuadri ligjor, Komisioneri Publik vlerëson se marrëdhënia kontraktuale e subjektit të rivlerësimit me shoqërinë “***” SHPK, bie ndesh me detyrimet ligjore për etikën, të tilla që mjaftojnë për t’u vlerësuar si rrethana papajtueshmërie në ushtrimin e funksionit të prokurorit për rastin konkret.

18.8 Komisioneri Publik vëren se Komisioni në ushtrim të funksionit të tij rivlerësues, referuar situatës konkrete, nuk arrin ndonjë konkluzion lidhur me detyrimet e etikës së subjektit dhe nuk arrin të identifikojë ekzistencën ose jo të ndonjë shkelje disiplinore në këtë rast, duke parashtruar në mënyrë të paqartë arsyetimin se: “...marrëdhënia kontraktuale ekzistuese midis subjektit dhe “***” sh.p.k. ... ka prodhuar dhe po prodhon efekte të përfitimeve të ndërthurura financiare brenda familjes së subjektit, që mund të krijojë dyshime mbi përfitimet për shkak të pozitës profesionale të z. Besnik Cani; ... Trupi Gjykses konsideron se sa më sipër mund të shkaktojë papajtueshmëri me funksionin e prokurorit²¹ [...]”.

18.9 Komisioneri Publik ndan qëndrimin se ky arsyetim mund të konsiderohet si i pamjaftueshëm në vlerësimin e situatës faktike me kufizimet e parashikuara nga Kushtetua, ligji nr. 96/2016 dhe Rregullores për Etikën dhe Sjelljen e Prokurorëve, në veçanti me detyrimin “të mos kryejë asnjë aktivitet ekonomik” dhe/ose detyrimin “të mos ndikohet nga interesat e grupeve të caktuara”, siç përcaktohet me ligj...

18.10 Komisioni, megjithëse pranon prezencën (mund të jetë shkak²²) e shkaqeve që çojnë në përgjegjësinë e subjektit, “...duke e kombinuar këtë rrethanë me mundësinë e shqyrtimit të saj nga një tjetër organ²³”, e transferon çështjen organit për inspektimin e shkeljeve disiplinore, me qëllim caktimin e një mase në përputhje me parimin e proporcionalitetit.

18.11 Në vlerësimin e Komisionerit Publik, arsyetimi i Komisionit, veç faktit se bazohet në ekzistencën e dyshimit, që në zbatim të ligjit duhej të ishte shuar nga mekanizmi procedural i barrës së provës, në mënyrë të gabuar, më së paku shmanget nga zbatimi i nenit 61, pika 5, të ligjit nr. 84/2016.

18.12 Edhe në këtë rast, në konsideratë të qëndrimit të mbajtur më sipër nga Komisioni për parimin e proporcionalitetit (pg. 8.2 – 8.3), për Komisionerin Publik mbetet i paqartë këndvështrimi që trupi gjykses i Komisionit ka lidhur me zbatimin e këtij parimi dhe vendit që ai zë në procesin e rivlerësimit²⁴.

19. *Procedimi penal nr.***, viti 2012, i Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Fier, së bashku me praktikën për përfitimin e statusit të pastrehë nga subjekti, në bazë të Vendimit të Këshillit Bashkiak Fier, nr.14, datë 28.3.2013*

19.1 Gjatë hetimit administrativ, bazuar në nenin 49, pika 3, të ligjit nr. 84/2016, nga burime të hapura, Komisioni ka ardhur në dijeni të disa fakteve lidhur me etikën dhe profesionalizmin e subjektit të rivlerësimit dhe, për këtë qëllim, ka administruar vendimin nr.14, datë 28.3.2013, të Këshillit Bashkiak Fier, “Për miratimin e listës me familjet e pastreha që do të përfitojnë nga programi social i kredisë së lehtësuar nga shteti për blerjen e banesave me kosto të ulët²⁵”, nga ku ka rezultuar si përfituese edhe bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit, znj. ***.***.

ose trajtimin preferencial për prokurorët dhe vendos për ta, rregullat mbi konfliktin e interesit, parashikuar nga ligji mbi parandalimin e konfliktit të interesit”.

²¹ Referuar nënpikës “iv-v”, f. 18, e vendimit.

²² Referuar nënpikës “v”, f. 18, e vendimit.

²³ Referuar nënpikës “vi”, f. 18, e vendimit.

²⁴ Përdorur edhe në rastin për truallin dhe banesën në ***, analizën financiare, përfitimi i statusit i pastrehë.

²⁵ Nga përgjigjja e Bashkisë Fier, kjo e fundit sqaron se nuk e disponon dosjen e plotë.

19.2 Nisur nga fakti se kjo periudhë përkon me: **(i)** kohën kur subjekti i rivlerësimit ka qenë drejtues i Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Fier dhe **(ii)** regjistrimin e një procedimi penal nga ana e Prokurorisë që drejtohej nga subjekti i rivlerësimit ndaj anëtarëve të Komisionit të Strehimit pranë Bashkisë Fier, rreth praktikave të ndjekura për përfitimin e kundërligjshëm të kredive të buta (*Vendimi i Këshillit Bashkiak nr.31, datë 9.7.2012*), Komisioni ka administruar materialet e këtij procedimi penal.

19.3 Ka rezultuar se në *** korrik të vitit 2012, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier ka regjistruar një kallëzim të depozituar nga një grup qytetarësh fierakë, të cilët pretendonin se nga ana e anëtarëve të Këshillit Bashkiak dhe drejtuesve të këtij institucioni ishin kryer veprime të paligjshme gjatë procedurave për miratimin e vendimit nr.31, datë 9.7.2012, në lidhje me listën e qytetarëve të pastrehë që do të përfitonin kredi lehtësuese.

19.4 Në datë *** korrik 2012, prokurorja e çështjes, së cilës i ishte kaluar për shqyrtim ky kallëzim, rezultoi të ketë marrë vendimin për mosfillimin e procedimit penal për kallëzimin nr. ***, datë ***.7.2012. Ky vendim mosfillimi u është komunikuar qytetarëve kallëzues nga ana e subjektit të rivlerësimit, në cilësinë e prokurorit më të lartë/drejtesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier.

19.5 Vendimi në fjalë i prokurorisë është ankimuar nga qytetarët në Gjykatën e Shkallës së Parë Fier, që, me vendimin e datës ***.2.2013, ka vendosur ta prishë vendimin e mosfillimit, duke detyruar prokurorinë të vazhdonte hetimet.

19.6 Ndërkohë, gjatë kësaj kohe, bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit rezultoi të ketë aplikuar për përfitimin e një kredie si familje e pastrehë pranë Bashkisë Fier. Me vendimin nr.14, datë 28.3.2013, Këshilli Bashkiak Fier ka përfshirë në listën e familjeve të pastreha që përfitonin kredi lehtësuese edhe familjen e subjektit të rivlerësimit.

19.7 Në vlerësimin e këtij rasti, Komisioni, megjithëse arsyetoi se “... ky veprim mund të bjerë ndesh me etikën e magjistratit dhe të ketë cenuar figurën e magjistratit, si dhe besimin e publikut në sistemin gjyqësor...”, në përfundim konkludoi se: “... në mungesë të provave ndërlidhëse me një ndikim të paligjshëm mbi Këshillin Bashkiak ose/dhe përfitim nga funksioni i drejtuesit të Prokurorisë, nuk mund të çojë në aplikimin e pikës 1, germa “c”, të nenit 58, të ligjit nr. 84/2016.”, duke vendosur kështu, edhe për këtë rast, transferimin e çështjes pranë organit kompetent inspektues për vlerësimin në harmoni me dyshimet e tjera profesionale dhe caktimin e një mase të mundshme disiplinore, në përputhje me parimin e proporcionalitetit.

19.8 **Komisioneri Publik**, në konsideratë edhe me gjetjet e trajtuara më sipër për etikën, vlerëson se provat e administruara në rastin në fjalë duhet të detyronin Komisionin në arritjen e një tjetër përfundimi, sikurse ka konstatuar fillimisht, lidhur me vlerësimin e kushteve dhe rrethanave për cenimin e etikës, figurës së magjistratit, duke cenuar në këtë mënyrë edhe besimin e publikut, sipas nenit 61, pika 5, të ligjit nr. 84/2016. Rrethana të cilat, në çmim të Komisionerit Publik, të çojnë në një rezultat të tillë.

19.9 Referuar shpjegimeve dhe provave të dorëzuara nga subjekti, pretendimet e tij mbeten në nivel deklarativ dhe kontradiktore, si dhe nuk arrin të shpjegojë bindshëm arsyet e aplikimit dhe fitimit të statusit të familjes së pastrehë, në kundërshtim me legjislacionin në fuqi. Komisioneri Publik vlerëson të nënvizojë se, sipas këtij legjislacioni, që rregullon rastet e përfitimit, ndër të tjera, dhe të kredive të buta, sipas nenit 4, të ligjit nr. 9232, datë 13.05.2004, “Për programet sociale të strehimit”, të ndryshuar, përfitojnë strehim: (i) individët që kanë mbushur moshën 18 vjeç dhe (ii)

familjet e regjistruara në zyrat e gjendjes civile në njësitë e qeverisjes vendore²⁶, të cilat, në momentin e aplikimit, plotësojnë kushtet e mëposhtme:

- a) **nuk kanë në pronësi një banesë**, ndërkohë subjekti kishte në pronësi truall + banesë në ***, apartament dhe garazh në rrugën “***.***”, Tiranë;
- b) **zotërojnë sipërfaqe banimi nën normat e strehimit**, të përcaktuara për atë kategori sociale dhe ekonomike, ku bëjnë pjesë këto familje, ose banojnë në banesa jashtë standardeve në fuqi; rrethana këto të cilat nuk rezultojnë për subjektin;
- c) kanë mbetur të pastrehë, si rezultat i fatkeqësive natyrore.

Përfshihen në njërin nga shkronjat “a”, “b” dhe “c” të pikës 1, të këtij neni, **vetëm ato familje**, që kanë të ardhura të pamjaftueshme, ndërkohë që të ardhurat familjare të subjektit kanë qenë disa herë mbi pragun ligjor përfitues.

19.10 Përmbushja e kriterëve të mësipërme ligjore specifikohet më tej në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 574, datë 29.8.2012²⁷, në fuqi kur është miratuar Vendimi i Këshillit Bashkiak Fier nr.14/2013. Sipas kriterëve të këtij akti nënligjor, pas fazës së parë, që përfshin aplikimin nga ana e personave që kërkojnë të përfitojnë, klasifikimit nëpërmjet sistemit të pikëzimit, seleksionimit të përfituesve dhe njoftimit, kalohet në fazën e dytë, ku familjet përfituese duhet të dorëzojnë dokumentacionin provues që mbështet aplikimin, ku, ndër të tjera, kërkohen një sërë dokumentesh²⁸.

19.11 Referuar listës së dokumenteve të kërkuara, pavarësisht faktit të pretenduar të mosdisbursimit të kredisë së butë në favor të familjes së subjektit, familja e tij rezulton përfituese e kësaj të drejte jashtë kriterëve ligjore dhe, në këto rrethana, Komisioneri Publik vlerëson se shpjegimet e subjektit të rivlerësimit, pas kalimit të barrës së provës, se ai nuk ka pasur dijeni mbi aplikimin nga ana e bashkëshortes së tij dhe përfshirjes në listën e përfituesve të kredive të buta, janë të pabazuara. Në konsideratë të faktit se: **(i)** procedimi penal rreth praktikave të ngjashme abuzive për trajtim me kredi të butë është zhvilluar gjatë periudhës 2012-2014, nga ana e prokurorisë ku subjekti ishte prokurori më i lartë/drejtues; **(ii)** përfshirja në listën e familjeve të pastreha të familjes së subjektit të rivlerësimit rezulton në mars 2013; **(iii)** natyra e dokumentacionit që kërkohej nga ligji të dorëzohej nga çdo aplikues; **(iv)** si dhe shpjegimet kontradiktore të subjektit, kur shprehet se kërkesa e bashkëshortes së tij “...*ishte kushtëzuar nga nevoja për të qenë më i pranishëm në familje, mundësia e paktë e transferimit në Tiranë, mundësia e likuiditeteve të nevojshme për të bërë të mundur blerjen e një banese në Fier*²⁹”, vijnë në kontradiktë me pretendimin e subjektit mbi mosdijeninë e tij për aplikimin për kredi nga ana e bashkëshortes së tij apo mospasjes së njohurive të duhura ligjore.

19.12 Si përfundim, në analizë të fakteve të mësipërme, Komisioneri Publik çmon se përfshirja jashtë kriterëve ligjore në listën e përfituesve të statusit të pastrehë i familjes së subjektit në qytetin

²⁶ Referuar deklaratimit të vendbanimit të subjektit pranë ILDKPKI-së, deklaratat e pasurisë në vitet 2012-2013, vendbanimi deklarohet vazhdimisht rruga “***.***”, Tiranë, apartamenti i analizuar si pasuria 1.

²⁷ Ky vendim ka shfuqizuar vendimin e mëparshëm të Këshillit të Ministrave nr. 53, datë 28.1.2005, i cili parashikonte (thujse) të njëjta dokumente.

²⁸ Certifikatën e lindjes së aplikantit dhe certifikatën e gjendjes familjare; vërtetimin për vendbanimin në bashkinë ku kërkohet strehimi ose lejen e banimit, për familjet që kanë lëvizur nga zona të tjera të vendit; vërtetimin e të ardhurave neto të familjes; dokumentacionin përkatës nga punëdhënësi për detyrën dhe të ardhurat e aplikantit e të personave të tjerë të familjes që janë në marrëdhënie pune; dokumentin nga organet tatimore dhe ato të sigurimeve shoqërore për derdhjen e kontributeve, për të gjithë anëtarët e vetëpunësuar të familjes; vërtetimin nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, se familja apo ndonjë anëtar i saj nuk disponojnë në pronësi banesë a ndonjë mjedis, që mund të përdoret si e tillë; vërtetimin nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme të vendit të origjinës, se nuk figuron e regjistruar asnjë pronë, e cila mund të përdoret edhe për strehim, për familjet, që kanë ndryshuar vendbanim për efekt punësimi.

²⁹ Referuar shpjegimeve të subjektit, datë 20.11.2018, pas kalimit të barrës së provës.

e Fierit, ndërkohë që ky i fundit ushtronte funksionin e prokurorit më të lartë/drejtuesit të prokurorisë së këtij qyteti, që po hetonte të njëjtët subjekte shtetërore për shpërdorim detyre dhe falsifikim dokumentesh në trajtimin e familjeve me kredi të buta, duket se është rrjedhojë e përfitimit të padrejtë, për shkak të funksionit dhe bie ndesh me përmbushjen e standardeve të etikës profesionale të magjistratit.

19.13 Komisioneri Publik, në ndryshim nga përfundimi i Komisionit, vlerëson se subjekti i rivlerësimit, me veprimet dhe mosveprimet e tij, pretendimet kontradiktore gjatë hetimit administrativ mbi dijeninë e tij, janë rrethana dhe qëndrim i cili vjen ndesh me standardet e etikës dhe kompromenton figurën e magjistratit (neni 61/4), e për rrjedhojë besimin e publikut në sistemin e drejtësisë (neni 61/5).

Lidhur me aftësitë profesionale

20. Procedimi penal nr.*, viti 2006, i Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë**

20.1 Mbi bazën e një denoncimi nga publiku, sipas nenit 53, të ligjit nr. 84/2016, nga hetimi administrativ megjithëse Komisionit i ka rezultuar se:

- (i) Subjekti, si prokuror i çështjes fillimisht ka vendosur “*mosfillim të procedimit penal*” dhe, vetëm pas kontrollit dhe urdhërimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë³⁰, ka kryer veprimet hetimore dhe ka vendosur dërgimin e çështjes në gjyq;
- (ii) Subjekti ka shfaqur sjellje pasive ndaj çështjes, duke mos kryer veprimet e nevojshme hetimore, administrim i gabuar i dosjes, vlerësim i gabuar i fakteve dhe referim i gabuar i bazës ligjore.

Megjithatë, Komisioni ka arritur të arsyetojë se: “*...ka konstatuar mangësi në veprimtarinë hetimore të subjektit, por gjithsesi duke vlerësuar se z. Besnik Cani e arrin, së paku, nivelin minimal kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale - ..., - Trupi Gjyqësor çmon se edhe dosjet që lidhen me këtë procedim penal, i përcillen pranë organit kompetent për inspektimin e shkeljeve të mundshme disiplinore*”.

20.2 **Komisioneri Publik** vlerëson se ky konkluzion i Komisionit nuk i përgjigjet vlerësimit tërësor të rrethanave të faktit dhe është rezultat i zbatimit të gabuar të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016. Mbeten të paqartë kriteret e përdorura nga Komisioni në arritjen e përfundimit se subjekti “*...arrin më së paku nivelin minimal kualifikues*”, kur ndërkohë Komisioni ka konstatuar se subjekti shfaq modele të njëjta pune, të përsëritura, me problematika të ngjashme edhe për dy raste të tjera të denoncuar³¹.

20.3 Në vlerësimin e Komisionerit Publik, nëse gjetjet dhe mangësitë e konstatuara do t’i nënshtroheshin vlerësimit objektiv sipas përcaktimeve të ligjit nr. 96/2016, subjekti rezulton me mangësi të njëjta, të përsëritura për të paktën këto kriteret e vlerësimi, si: (i) aftësitë profesionale; (ii) aftësitë organizative dhe (iii) arsyetimi ligjor.

21. Procedimi penal nr. * , viti 2015, i Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Elbasan**

21.1 Kjo çështje është përzgjedhur nga Komisioni për t’u vlerësuar mbi bazën e shortit. Rezulton se procedimi penal nr. ***/2015 është regjistruar për veprën penale “Kanosje e gjyqtarit” dhe prokurori i çështjes ***.***, pasi ka kryer veprimet e nevojshme hetimore, në përfundim, ka

³⁰ Gjykata në arsyetimin e saj përmend faktin se organi i prokurorisë nuk ka pasur parasysh provat dhe faktet që janë paraqitur nga kallëzuesi, si dhe dy vendime me të njëjtën numër dhe datë, por me përmbajtje të ndryshme.

³¹ Denoncim nga shtetasi ***.***, dhe ***.***.

vendosur ta dërgojë për gjykim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan. Kjo vendimmarrje e prokurorit të çështjes ka kaluar për kontroll dhe konfirmim te drejtuesi i prokurorisë, subjekti i rivlerësimit. Rezulton se ky i fundit ka vendosur shfuqizimin e vendimit për dërgimin e dosjes dhe kërkesës për gjykimin e çështjes penale.

21.2 Referuar analizës së kryer nga subjekti për shfuqizimin e këtij vendimi, konstatohen mangësi në kryerjen e hetimeve të thelluara, cilësim korrekt i veprës penale dhe referim i gabuar i dispozitës, që gjen zbatim në rastin konkret. Përtej pranisë së elementeve të figurës së veprës penale të kanosjes, fakt ky i pohuar edhe nga subjekti në arsyetimin e tij, rezulton se është injoruar prezenca e elementeve penale edhe për një vepër tjetër, atë të fyerjes së gjyqtarit (n. 318, i Kodit Penal), duke konsideruar gabimisht se ajo mund të ndiqet kryesisht nga i dëmtuari akuzues, sipas nenit 59, të K. Pr. Penale.

21.3 Marrë në konsideratë se pushimi i hetimeve, referuar kualifikimit të gabuar të veprës penale dhe arsyetimit ligjor, ndaj kallëzimit të një prokurori në cilësinë e të dëmtuarit, jepet nga prokurori më i lartë/drejtuesi i prokurorisë, ky fakt, në kuadër të rivlerësimit të aftësive profesionale merr rëndësi dhe peshë edhe më të madhe. Edhe në këtë rast, Komisioni konkludon se: *“...duke mbajtur parasysh faktin se gjithsesi, subjekti ka arritur, së paku, një nivel minimal kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale - ky vendim, transferohet, në bazë të pikës 4, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016, pranë organit kompetent për inspektimin e shkeljes disiplinore....”*.

22. Komisioneri Publik konstaton se mangësitë dhe problematikat e vërejtura në mënyrë të përsëritur edhe nga Komisioni, në rastet e mësipërme, bazuar në një vlerësim objektiv mbi kriteret e përcaktuara ligjore, duhet të çojnë në zbatimin e nenit 61, pika 4 dhe 5, të ligjit nr. 84/2016. Përkundër kësaj, Komisioni bazuar në një interpretim të gabuar të nenit 59, pikat 1, 2, 3 dhe 4, lidhur me nenin 61, pika 4 apo 5, të ligjit nr. 84/2016, vendos transferimin e katër çështjeve organit inspektues.

22.1 Nisur nga specifikat e hetimit dhe vendimmarrjes së Komisionit, të pasqyruara në arsyetimin dhe dispozitivin e vendimit nr. 84/2018, Komisioneri Publik, duke mbetur i bindur se çështjet e transferuara tek organi disiplinor, në rastin konkret duhen konsideruar se përmbajnë të gjitha elementet e kërkuara nga dispozitat e nenit 61, pika 4 dhe 5, të ligjit nr. 84/2016, por në konsideratë të rolit kontrollues dhe orientues sipas nenit 66, të ligjit nr. 84/2016, për të rregulluar ecurinë e mëtejshme të procesit të rivlerësimit, në kuptim të zbatimit të nenit 59/a, të ligjit nr. 84/2016, merr shkak t’i kërkojë Kolegjit të marrë në shqyrtim dhe të shprehet për çështjet si vijojnë:

- (i) A mundet Komisioni të heqë dorë nga juridiksioni i tij rivlerësues në lidhje me kriterin profesional, kur sipas Kushtetutës, aneksit të saj dhe ligjit nr. 84/2016 është kompetencë e plotë dhe detyrë e tij (Komisionit) kryerja e rivlerësimit kalimtar të subjekteve për qëllim të nenit 179/b, pika 1, të Kushtetutës. Përpara se Komisioni t’ia transferojë çështjet një tjetër organi kompetent për inspektim, kjo vendimmarrje a duhet të udhëhiqet nga një proces paraprak vlerësimi lidhur me plotësimin e kushteve që neni 59/4, të ligjit nr. 84/2016, kërkon, si “evidentimin e shkaqeve që përbëjnë shkelje disiplinore” apo “shkaqeve për t’u marrë parasysh gjatë vlerësimit periodik të subjektit”?
- (ii) Në çdo rast, kjo lloj vendimmarrje e Komisionit sipas nenit 59/4, të ligjit nr. 84/2016, a do të duhet të kufizohet në lidhje me numrin e çështjeve/praktikave që mund t’i transferohen organit kompetent për inspektim?

22.2 Në mbështetje të parashtrimit të këtyre çështjeve që mund të vlerësohen nga Kolegji për t’u trajtuar, në zbatim të kompetencës së tij orientuese, vlen të theksohet se në disa vendime të

mëparshme, Komisioni ka referuar më së shumti një çështje tek organi kompetent inspektues, ndërsa në rastin objekt ankimi, ka vendosur transferimin e 4 çështjeve/praktikave, duke përjashtuar në këtë mënyrë zbatimin e nenit 61/5, të ligjit nr. 84/2016, lidhur me nenin 4, pika 2 e tij.

22.3 Në këtë kuptim, është në vlerësimin e Komisionerit Publik, se për të shmangur rrezikun e transferimeve *a priori* të çështjeve tek organi kompetent për inspektim, ligjvënësi ka parashikuar që organi rivlerësues (Komisioni) duhet që të bindet dhe arsyetojë paraprakisht nëse rezultatet e dala nga hetimet administrative të tij nuk përbëjnë lëndë vlerësimi për qëllim të nenit 179/b, pika 1, të Kushtetutës, nenit E, të aneksit apo nenit 61, pika 4 dhe 5, të ligjit nr. 84/2016, pasi në tilla rrethana, nga vlerësimi tërësor i çështjes, është e qartë se neni 59/1 (i cili aktivizon 59/4), i këtij ligji nuk gjen hapësirë, dhe neni 65/1 merr përparësi zbatimin.

II. Kërkimi i ankimit

23. Në përfundim të këtyre parashtrimeve, Komisioneri Publik çmon se:

23.1 Subjekti i rivlerësimit nuk arrin nivel të besueshëm për konfirmimin e tij në detyrë, pasi gjendet në kushtet e deklaramit të pasaktë, rezultojnë me mungesë burimesh financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë e deklaruara dhe ka kryer deklaramit të pamjaftueshëm, në kuptim të nenit D, të aneksit të Kushtetutës, nenit 33, pika 5, germa “b” dhe nenit 61, pika 3, të ligjit nr. 84/2016;

23.2 Subjekti i rivlerësimit nuk arrin nivel kualifikues për kriterin e aftësive profesionale, pasi nga rrethanat dhe faktet e administruara, rezultojnë se subjekti ka cenuar etikën dhe figurën e magjistratit, duke pasjellë dhe cenimin e besimit të publikut të drejtësia. Konstatohen mangësi dhe problematika në mënyrë të përsëritur, të cilat, në një vlerësim objektiv dhe tërësor të tyre, referuar kriterëve të përcaktuara ligjore, duhet të çojnë në zbatimin e nenit 61, pikat 4 dhe 5, të ligjit nr. 84/2016. Përkundër kësaj, Komisioni, bazuar në një interpretim dhe zbatim të gabuar të këtij ligji dhe parimit të proporcionalitetit, ka vendosur transferimin e katër çështjeve organit kompetent inspektues;

23.3 Për sa më sipër, bazuar në nenet Ç, D, DH, E dhe F, të aneksit të Kushtetutës, nenet 30-34, 40-44, pikës 3, 4 dhe 5, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016;

23.4 Komisioneri Publik kërkon që shkaqet e këtij ankimi të merren në shqyrtim nga ana e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit dhe, në zbatim të nenit 66, pika 1, germa “b”, të ligjit nr. 84/2016, në përfundim të shqyrtimit të çështjes, të vendosë:

- Ndryshimin e vendimit nr. 84, datë 27.11.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z. Besnik Cani.

KOMISIONERI PUBLIK

Florian BALLHYSA